

KLSH merr pjesë në Konferencën “Mbi auditimin e Llogarive të Buxhetit të Shtetit” organizuar nga SIGMA dhe SAI i Malit të Zi

Në datat 27 – 29 Shkurt 2024, në Budva, Mali i Zi u zhvillua konferenca e rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të rajonit me statusin kandidat dhe kandidat të mundshëm për anëtarësim në BE me temë auditimin e llogarive të konsoliduara të Buxhetit të Shtetit. Kjo konferencë u zhvillua nën drejtimin e SIGMA-s, si një iniciativë për shkëmbimin e eksperiencave dhe adresimin e sfidave të përbashkëta me qëllim përshpejtimin e procesit të anëtarësimit nëpërmjet kontributit që institucionet supreme të auditimit japin në kuadër të llogaridhënies dhe mirëqeverisjes.

Temat kryesore që u prezantuan përfshijnë efektet dhe pritshmëritë e auditimit të llogarive të konsoliduara të buxhetit të shtetit, roli këshillues i institucioneve të auditimit në buxhetim dhe reformat e kontabilitetit të sektorit publik, maksimizimi i efikasitetit dhe përfitimeve të auditimit të llogarive të konsoliduara të buxhetit të shtetit, përcaktimi dhe kuantifikimi i kriterëve të auditimit për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë si dhe formulimi i rekomandimeve dhe masave në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë.



Nga ana e SIGMA-s u prezantuan Parimet e rishikuara të Administratës Publike duke u fokusuar në ndryshimet kryesore në krahasim me parimet e vitit 2014, të cilat reflektojnë zhvillimet më të fundit në standardet dhe praktikën në BE, OECD dhe organizata të tjera ndërkombëtare për një përgjigje më të mirë ndaj sfidave si transformimi dixhital dhe qëndrueshmëria mjedisore.

Pjesëmarrës në konferencë për herë të parë ishin edhe përfaqësues nga Ministritë e Financave të vendeve të rajonit, me qëllim shkëmbimin e ideve dhe këndvështrimeve për përmirësimin e procesit të auditimit të llogarive të konsoliduara të buxhetit dhe kryesisht në pjesën e formulimit të kriterëve dhe rekomandimeve të auditimit, me qëllimin përfundimtar përcjelljen e vlerës së shtuar në të mira dhe shërbime për qytetarët.

Në këtë takim KLSH u përfaqësua nga Z. Gjovalin Preçi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe Z. Rigels Guzi, auditues në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit.